




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ZYRËS SË KRYEMINISTRIT PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Zyrës së Kryeministrit për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Zyrës së Kryeministrit (ZKM), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Zyrës së Kryeministrit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të ZKM kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

U.D Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, U.D Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

U.D Sekretar i Përgjithshëm, Zyra e Kryeministrit të Kosovës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Zyrës së Kryeministrit.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Zyrës së Kryeministrit është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Zyrës së Kryeministrit në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

**Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Zyrës së Kryeministrit me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Zyrës së Kryeministrit.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, e cila është paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Kjo ka për qëllim të përmirësojë kontrollet e brendshme lidhur me pajtueshmërinë me autoritetet sa i përket menaxhimit të shpenzimeve dhe obligimeve.

Ky raport ka rezultuar me dy (2) rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.1.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë ishte 6,610,632€, prej tyre ishin shpenzuar 4,006,322€ apo 61%. Ato kanë të bëjnë me furnizime për zyrë, pajisje nën 1,000€, kompjuter më pak se 1,000€, shërbime kontraktuese tjera, dreka zyrtare etj.

#### Çështja B1 - Urdhërblerjet pas pranimit të faturës

##### Gjetja

Neni 22 i Rregullës financiare nr.01/2013 - Shpenzimi i parasë publike përcakton që: fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Gjatë testimeve kemi vërejtur që në pesë (5) pagesa në vlerë 25,657€, urdhërblerjet ishin proceduar pas pranimit të faturës.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e dështimit të kontroleve nga zyra e prokurimit me rastin e procedimit të urdhërblerjes.

##### Ndikimi

Procedimi i urdhërblerjeve pas pranimit të faturës paraqet shmangie të procedurave të përcaktuara me rregullat financiare dhe rritë rrezikun që të pranohen mallra apo shërbime jo në pajtim me kushtet e kontraktuara.

##### Rekomandimi B1

Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të nxjerrën urdhërblerjet para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blerjet e pa kontrolluara.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.1.2 Detyrimet e papaguara

Obligimet e papaguara në ZKM të prezantuara në PVF në fund të vitit 2023 ishin 96,158€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2024. Ato kishin të bëjnë me kategorinë mallra dhe shërbime dhe komunal.

### Çështja B2 - Vonesa në pagesën e obligimeve

**Gjetja** Neni 39.1 i LMFPP përcakton që: ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në gjashtë (6) raste në vlerë 50,198€, kemi vërejtur që faturat e pranuar nuk ishin paguar me kohë. Vonesat ishin nga 9 deri në 49 ditë, pas afatit të lejuar për pagesë prej 30 ditësh.

Kjo praktikë ishte raportuar edhe në raportet e viteve të kaluara dhe si e tillë, po përsëritet vit pas viti për shkak të dobësive në kontrollet e brendshme sa i përket pagesës së faturave me kohë.

**Ndikimi** Tejkalimi i afatit ligjor për pagesën e obligimeve mund ta bëjë ZKM-në subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbarimore apo obligime për vitin vijues.

**Rekomandimi B2** Sekretari i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha faturat e pranuar të paguhen brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>7</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>21,986,762</b>	<b>15,761,593</b>	<b>9,462,714</b>	<b>10,854,913</b>	<b>9,496,904</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	21,986,762	13,989,619	8,639,180	10,066,903	8,723,672
Financimi përmes huamarrjes	0	78,625	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	0	0	10,901	106,085
Të hyrat vetanake	0	0	0	0	55,856
Donacionet vendore	0	19,612	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	1,673,738	823,534	777,110	611,291

Buxheti përfundimtar është më i ultë se buxheti fillestar për 6,225,169€. Ky ndryshim ishte si rezultat rritjes nga donacionet në vlerë 1,693,350€ dhe huamarrjes 78,625€, e pastaj zvogëlimit në vlerë 7,997,144€ si rezultat i shkurtimeve buxhetore për shkak të shtyrjes së procesit të regjistrimit të popullsisë për vitin e ardhshëm.

Në vitin 2023, ZKM ka shpenzuar 60% të buxhetit përfundimtar ose 9,462,714€, me një zvogëlim për 8% në krahasim me vitin 2022.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>21,986,762</b>	<b>15,761,593</b>	<b>9,462,714</b>	<b>10,854,913</b>	<b>9,496,904</b>
Pagat dhe mëditjet	3,717,785	3,781,711	3,765,146	3,960,147	3,908,997
Mallrat dhe shërbimet	12,680,065	6,527,082	3,981,589	3,122,374	3,151,301
Komunalitë	83,225	83,550	24,733	83,831	81,574
Subvencionet dhe transferet	5,505,687	4,990,919	1,353,532	3,408,425	2,124,025
Investimet Kapitale	0	378,331	337,714	280,135	231,007

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e ekonomike janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje, në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 63,926€, për shkak të ndryshimeve në ligjin e ri të pagave. Realizimi në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime, në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 6,152,983€. Ky zvogëlim i buxhetit ishte si rezultat i vendimit të qeverisë për kursime buxhetore. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte vetëm 61% e buxhetit final si rezultat i shtyrjes për vitin e ardhshëm të procesit të regjistrimit të popullsisë.
- Buxheti final për komunalitet në raport me buxhetin fillestar rritur për 325€, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 30%. Mosrealizimi i buxhetit ishte për shkak se këto shpenzime ishin planifikuar për t'u shpenzuar nga agjencitë e ZKM-së (përfshirë ASK-në) duke qenë se shfrytëzojnë të njëjtin objekt, derisa pagesa ishte kryer nga ZKM.
- Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 514,768€, ndërsa realizimi në këtë kategori ishte 27%. Realizimi i ultë i buxhetit ishte si rezultat i mosrealizimit të projekteve “Young Cell Scheme” në vlerë 500,000€ dhe “Programi për promovim të vendit” në vlerë 2,000,000€, ndërsa projekti “Përkrahje për Luginën e Preshevës” në vlerë 2,000,000€ ishte shpenzuar vetëm 16%.
- Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 378,331€, si rezultat i vendimit të Qeverisë për mjete shtesë prej 221,000€ në projektin kapital “Furnizim me pajisje të IT” për blerjen e softuerit për regjistrimin e popullsisë së Kosovës si dhe transferit prej 146,965€ si kapital të entiteteve publike sipas marrëveshjes me donatorët e Qeverisë Norvegjeze. Realizimi për këtë kategori ishte 89%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



ZKM në vitin 2023 kishte realizuar të hyra në vlerë 1,435€. Ato kanë të bëjnë me shitjen e banesave të institucioneve publike qendrore. Ndryshimi i të hyrave krahasuar me vitet e kaluara është për shkak të transferimit të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinës (AUV) në kuadër të Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR-së) nga viti 2023.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>8,151,256</b>	<b>8,151,256</b>	<b>1,435</b>	<b>6,890,735</b>	<b>7,081,538</b>
Të hyrat jo tatimore	8,151,256	8,151,256	1,435	6,880,235	7,027,738
Të hyrat tjera	0	0		10,500	53,801

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për ZKM-në për vitin 2022 kishte rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. ZKM kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'a zbatoj rekomandimin e dhënë dhe kishte dorëzuar Raportin e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit. Nga gjashtë (6) rekomandimet e dhëna, deri në fund të auditimit për vitin 2023, ZKM ka zbatuar katër (4) rekomandime, derisa dy (2) rekomandime ishin të përsëritura.

Në këtë auditim, ne i kemi testuar rekomandimet sa i përket ZKM-së, ndërsa pjesën tjetër që i përket AUV-it është vlerësuar dhe do të paraqitet në raportin e auditimit të MBPZHR-së për shkak se AUV-i nga viti 2023 vepron në kuadër të kësaj ministrie.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën e rekomandimeve nr.4.

**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të forcojnë masat e përgjegjësisë ndaj zyrtarëve financiar dhe zyrtarëve tjerë administrativ për të siguruar se të gjitha obligimet do të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh pas pranimit të faturave.	Në kuadër të auditimit të ZKM çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2023	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Sekretari i Përgjithshëm në bashkëpunim me Kryeshefin e AUV-it duhet të sigurohen që të nxjerrën urdhërblertet para se të pranohen mallrat dhe faturat në mënyrë që të respektohen procedurat dhe të evitohen blertet e pa kontrolluara.	Në kuadër të auditimit të ZKM çështja e njëjtë ka rezultuar edhe në vitin 2023	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit






Arta Birinxhiku, Udhëheqëse e ekipit



Abdurrahmon Bërbatovci, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

		
<b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b> <b>Qeveria - Vlada-Government</b> <b>Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister</b> <b>Sekretari i Përgjithshëm - Generalni Sekretar - General Secretary</b>		
Datë: 23.05.2024 Ref: 063/2024		
<b>LETËR E KONFIRMIMIT</b>		
Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve		
Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit		
Të nderuar,		
Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:		
<ul style="list-style-type: none"><li>• Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Kryeministrit, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");</li><li>• Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe</li><li>• Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'iu dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshij afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.</li></ul>		
 Arben KRASHNIQ U.d. Sekretar i Përgjithshëm		

## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>8</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>9</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

### Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> B1 Furnizim me kompjuter në vlerë 16,325, furnizim me kompjuter në vlerë 4,740€, shërbime tjera kontraktuese në vlerë 1,800€, shërbime shtypi, marketingu, ceremoniale, festive në vlerë 1,630€ dhe shërbime tjera kontraktuese në vlerë 1,162€.
- <sup>6</sup> B2 Furnizim me kompjuter në vlerë 16,325€, shërbime për informim publik në vlerë 11,740€, dreka zyrtare në vlerë 11,151€, shërbime të përkthimit në vlerë 4,796€, qiraja për vetura në vlerë 4,162€ dhe shërbimet e shtypjes-printimit në vlerë 1,844€.
- <sup>7</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>8</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>9</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.